



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Top Radio  
Astrit Dema  
Drejtor  
Gjakovë



### VENDIM

#### **Lidhur me Rastin Nr. 2023/154 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Top Radio (Pala Përgjegjëse)**

#### Faktet

1. Pala përgjegjëse me datën 12 mars 2010, është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Gjakovë. Me marrjen e Licencës Ofruesi i shërbimit medial Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datën 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejt dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. Me datë 10 mars 2017, KPM mori Vendim për ripërtëritjen e licencës së Pala përgjegjëse edhe për një afat prej 7 viteve, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, ashtu siç përcaktohet (7) viteve, me nenin 21 paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në.
4. KPM me datën 6 tetor 2022, përmes emailit ka dërguar formën për të përditësuar të dhënat e përgjithshme të subjekteve transmetuese, formë e cila është dërguar edhe tek Pala përgjegjëse.
5. KPM me datën 12 tetor 2022, përmes emaili ka pranuar nga Pala përgjegjëse formën e plotësuar të të dhënave ku figurojnë emri i pronarit, Adnan Krasniqi dhe drejtoreshës Dionisa Haxhiavdyli, ndërsa sipas licencës së KPM-së pronar i Top Radio është Astrit Dema. Zyra Ekzekutive pas pranimit të formës me ndryshimet e bëra, përmes telefonit ka kontaktuar me drejtoreshën e lartpërmendur e cila e ka pohuar se ka ndodhur ndryshimi i pronësisë, dhe se ky ndryshim sipas sajë është bërë edhe në Asgjësinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe se tani si biznes Top Radio është në emrin e Adnan Krasniqi.

6. KPM duke u bazuar në faktin së Pala përgjegjëse ka bërë ndryshime në pronësi, me datën 17 dhjetor 2022, i ka dërguar shkresë përmes të cilës e ka njoftuar për shkeljet e bëra lidhur me ndryshimin e pronësisë pa miratim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
7. Pala Përgjegjëse me datën 27 prill 2023, ka dorëzuar në KPM kërkesë për ndryshim të pronësisë, ku në certifikatën e regjistrimit të biznesit në të cilën është lëshuar licenca e Palës përgjegjëse, “Top Radio Kompany” Sh.p.k. me Numër Unik Identifikues 810232009 (figuron edhe numri i mëparshëm i biznesit 70002348), vërehet se është bërë ndryshimi i pronarit si person fizik nga z. Astrit Dema tek z. Adnan Krasniqi.
8. KPM bazuar në Raportin e departamentit të licencimit të datës 27 tetor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

#### Analiza ligjore

9. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
10. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:  
*“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.”*
11. Në kundërshtim me nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2021/01, i cili përcakton se:  
*“ Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen pa autorizim dhe pa aprovim paraprak me shkrim nga KPM”.*
12. Në kundërshtim me nenin 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, dhe paragrafin 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, i cili përcakton se:  
*2. “I licencuari nuk mund të bartë licencën ose frekuenc-ën(at) pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së.”*  
*2.1. “Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovim me shkrim nga ana e KPM-së.”*



3. "Kontrolli Efektiv i Frekuencës: I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë, plotësisht ose pjesërisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së."

13. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse dhe përkundër shkresës se datës 17 dhjetor 2022, ka dështuar të plotësoj kërkesën me dokumentet për ndryshimin në pronësi sipas udhëzimit të KPM-së.
14. KPM bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, nenit 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, nenin 15 paragrafin 2, paragrafin 2.1, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, duke bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së.

### Vendim

15. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Gjobë** në shumën prej njëmijë (1.000) euro në pajtim me 30, paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18 Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, nenit 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
16. Pala përgjegjëse, obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi ta plotësoj kërkesën me dokumentet për ndryshim në pronësi, në mënyrë që të veprojë në pajtimin me nenin 21, paragrafin 3 të Ligjit të KPM-së, nenin 18, Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

### E drejta për ankesë

17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI  
Kryetar



24.11.2023

Datë